



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 313/04-15778 dt. 29/04/ 2025



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit nr. 2004/18 për Tegetin e Brendshme, Ligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme.
Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.04.2025, miratoi këtë:

Plotësim Ndryshimi i Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Bizneseve në Komunën e Drenasit

NENI 1

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

NENI 2

- **Ndryshohet Neni 15 – Pika - 15.1.**

Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private (e hëne - e shtune)

15.1.1 Orari i punës për barnatore, ordianca dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonat dhe fillon prej orës 08:00, ndërsa mbaron në orën 22:00.

15.1.2 Orari i punës për barnaret kujdestare në Komoran dhe Drenas do të jetë:

Në sezonin veror 08:00 deri 20:00 ndërsa;

Në sezonin dimëror 08:00 deri 19:00.

(Përfshihet të shtunave orari i rregullt do të jetë nga ora 08:00 deri në ora 14:00)

- **Ndryshohet Neni – Pika - 15.2.**

16 Në rast të nevojave emergjente mund të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt (të dielave dhe gjatë festave shtetërore) sipas paragrafit 15.1.1. me një akte të veçantë.

- **Ndryshohet Neni – Pika - 15.3.**

Barnaret që veprojnë në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran do të kujdestarojnë:

Në sezonin veror nga ora 20:00 deri në 08:00 ndërsa

Në sezonin dimëror nga 19:00 deri në 08:00;

Ndërsa të shtunave orari i kujdestarisë do të filloj nga ora 14:00 deri në ora 08:00 njëjtë në të dy sezonet, si dhe dielave e festave zyrtare do të kujdestarohet 24 orë pa ndërprerë.

Shtohet : Neni – Pika - 15.4.

Orari i kujdestarive do të përpilohet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik sipas listës së caktuar për barnatoret në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran të caktuar nga Drejtoria e Inspektionit çdo fund vit dhe në rast të ndryshimeve aktuale.

NENI 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrari
Bekim Lestrari

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Gjatë zbatimit në praktik të Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019 ndjehet e nevojshme të bëhet plotësim/ndryshimi i nenit 15 të rregullores. Bazuar në kërkesat e kohëpaskohshme të bizneseve konkretisht barnatoreve të cilat operojnë në qendër në Drenas dhe barnatoreve në qendër në Komoran lidhur me përpilimin e orarit të kujdestarive të barnatoreve, kërkohet nga ana e kryetarit të Komunës që të bëjë Plotësim ndryshimi e Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

Me respekt.



1823/06
13.05.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Për:	Rramiz Lladrovci– Kryetar i Glllogocit Arianit Sadiku - Kryesues i Kuvendit të Glllogocit
Kopje:	Jeton Qela, U.d. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Erblin Hetemi, U.d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Përmes:	Samire Ademi Zefaj, U.d. Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Lulzim Kadriu, U.d. Drejtor i Departamentit Ligjor
Lënda :	Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Rregullore 02 Nr.313/01-15776

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për Ndryshim-Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MINT me datë: 08.05.2025 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Rregulloren 02 Nr.313/01-15776 Për plotësim

ndryshimin e Rregullores komunale Për fillimin dhe mbarimin e Orarit të Punës të organizatave të biznesit në Komunën e Glllogocit, andaj si Ministri:

KONFIRMON

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës së Glllogocit, konkretisht Rregulloren 02 Nr.313/01-15776 Për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale Për fillimin dhe mbarimin e Orarit të Punës të organizatave të biznesit në Komunën e Glllogocit, vlerëson se Rregullorja në fjalë nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi as me ndonjë akt nënligjor tashmë të miratuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

ARSYETIM

Sipas Ligjit Nr. 2004/ 18 Për Tregtinë e Brendshme neni 40 e përcakton se Orarin e punës, përcaktimin e orarit ditor dhe javor të shitoreve dhe objekteve të tjera, orarin e punës gjatë ditëve të festave dhe fundjavës, për të cilat shitësi detyrohet të punojë, orarin e punës për tregje, panaire dhe ekspozitat e karakterit lokal dhe formave të tjera të ushtrimit të veprimtarisë tregtare e përcakton administrata lokale në pajtim me dispozitat që i nxjerr Ministri i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Andaj bazuar në legjislacionin e lartë përmendur dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës së Glllogocit, konstatohet se kjo Rregullore nuk është në kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore e nënligjore të kësaj Ministrie.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë.

Me respekt,